



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenin 64, paragrafi (3) nga Ligji i Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 221/18)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14, 223/15 dhe 218/16), në pikën 19-dh.), në paragrafin (1), nënparagrafin 19-dh.3.) dhe 19-dh.4.) fjala:

"pozicionet" zëvendësohet me fjalën: "instrumenetet".

Në paragrafin (2) fjala: "pozita" zëvendësohet me fjalën: "instrumenti", fjala: "e cila" zëvendësohet me fjalën: "i cili", dhe fjala: "i saj" zëvendësohet me fjalën: "i tij".

2. Në pikën 19-h.), paragrafi (1), ndryshohet dhe thotë:

"Pa marrë pëlqimin nga Banka Popullore, banka nuk mund të zvogëlojë shumën e mjeteve vetanake përmes:

1) Blerjes ose uljes së vlerës së instrumenteve që janë pjesë nga kapitali i rregullt bazë;

2) T'i blejë ose t'i shlyen instrumentet që janë pjesë nga kapitali bazë shtesë,

3) Blerja ose shlyerja e instrumenteve të cilat janë pjesë nga kapitali shtesë, para afatit të dakorduar të maturimit."

Në paragrafin (4), në nënparagrafin (1) fjalët: "funksionim, ose," zëvendësohen me fjalët: "Funksionim, dhe/ose".

Në paragrafin (7), në nënparagrafi (2) pas fjalës: "vite", shtohet presje dhe fjalët: "duke pasur parasysh politikën afariste të bankës".

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

V nr. 02-15/XVIII-1/2018
29 nëntor 201
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
д-р Анита Ангеловска-Бежоска